



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

**PËR
SHKENCËN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti i ligjit**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të shkencës në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj është i zbatueshëm për cdo institucion që është pjesë e sistemit të kërkimit shkencor.

**Neni 2
Qëllimi dhe objektivat**

1. Ky ligj ka për qëllim:
 - a) të krijojë kushte për zhvillimin dhe funksionimin e një sistemi bashkëkohor të shkencës;
 - b) të garantojë mundësimin e financimit të këtij sistemi nga burime të ligjshme.
2. Ligji synon arritjen e objektiveve si më poshtë:
 - a) Sigurimin e produkteve të kërkimit shkencor që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, si dhe konsolidimin e identitetit kombëtar;
 - b) përvetësimin e aftësive dhe njohurive të reja, transferimin e tyre për përfitimin e përgjithshëm publik, me synim rritjen e mirëqenies sociale;

- c) fuqizimin e aftësive për të menaxhuar progresin teknologjik dhe të përgjithshëm shoqëror, si burimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur vlerën e punës dhe konkurrueshmërinë;
- d) fuqizimin e lidhjeve ndërkombëtare të komunitetit të studiuesëve shqiptarë me ato të zonës europiane të kërkimit, si dhe me kërkuesit e diasporës, duke promovuar lëvizshmërinë dhe përfshirjen në proceset e integritit evropian dhe në rrjetet ndërkombëtare të vlerave;
- e) ngritjen e kapaciteteve të personelit shkencor dhe nxitjen e zhvillimit të karrierës shkencore duke siguruar mundësi të barabarta;
- f) rritjen e përdorimit të infrastrukturës kërkimore shkencore duke garantuar akses për të gjithë;
- g) fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e kërkimit shkencor, me qëllim zhvillimin dhe shfrytëzimin e potencialeve kërkimore-shkencore;
- h) nxitjen e bashkëpunimit midis institucioneve të kërkimit - shkencor dhe biznesit, institucioneve publike, shoqërisë civile, si dhe palëve të tjera të interesuara në veprimtari kërkimore shkencore dhe inovacion;
- i) promovimin, zgjerimin e rolit të shkencës dhe krijimin e një mjedisi favorizues dhe mbështetës për kërkimin shkencor në shoqëri.

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Fushat e kërkimit shkencor të një rëndësie të veçantë” janë ato fusha të kërkimit shkencor që lidhen me sigurinë kombëtare, të drejtat e njeriut dhe shëndetin publik.
2. “Grup kërkimor” është një grup kërkuesish, bashkëpunëtorësh teknikë dhe profesionistë, që kryen veprimtari kërkimore shkencore në institucionet e kërkimit shkencor.
3. “Infrastruktura e hapur” është akses i hapur i institucioneve kërkimore-shkencore, në infrastrukturë kërkimore, të financuara nga burime të ligjshme financiare kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. “Inovacioni” është përfshirja e një produkti, shërbimi ose procesi, si një metodë e re për organizimin e punës, prodhimin e produkteve si dhe mënyrën e menaxhimit, e cila përmirëson dukshëm performancën e institucionit kërkimor-shkencor.
5. “Kërkim-zhvillim” është puna krijuese dhe etike, e ndërmarrë nga individë ose organizata në mënyrë që të rriten njohuritë për njerëzimin, kulturën dhe shoqërinë, si dhe për të krijuar aplikime të reja të njohurive.
6. “Ministri” është Ministri përgjegjës për çështjet e shkencës në Republikën e Shqipërisë.
7. “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës në Republikën e Shqipërisë.
8. “Projekt kërkimor-shkencor” është tërësia e veprimtarive kërkimore shkencore, që organizohen për një qëllim të caktuar, për të arritur rezultatet e pritshme, nëpërmjet një metodologjie kërkimore.

9. “Punonjësi kërkimor shkencor” është individi i angazhuar në veprimtari të kërkimit shkencor dhe plotëson kriterte e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, për këtë kategori.
10. “Sistemi i shkencës” është tërësia e institucioneve politikëbërëse, drejtuese, vlerësuese, financuese dhe ushtruese të veprimtarisë së kërkimit dhe zhvillimit shkencor, inovacionit, transferimi i teknologjisë, si dhe menyra e organizimit dhe funksionimit të tyre.
11. “Shkenca e hapur” është akses i hapur i publikut në metodologjitë, proceset e përpunimit të të dhënave dhe ne rezultatet e kërkimit shkencor duke respektuar parimet e etikës dhe mbrojtjes së pronësisë intelektuale.
12. “Shkencë” është tërësia e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit shkencor, si dhe inovacioni dhe transferimi i teknologjisë.
13. “Veprimtari kërkimore shkencore” është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga kërkuesi me qëllim që të gjenerojë njohuri ose aplikime të reja.

Neni 4

Parimet bazë të sistemit të shkencës

1. Veprimtaritë e sistemit të shkencës bazohen në parimet e lirisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, barazisë gjinore, transparencës, shkencës së hapur, konkurrencës, cilësisë, efikasitetit, etikës dhe përgjegjshmërisë.
2. Liria e kërkimit shkencor i garantohet çdo individi ose organizate në përputhje me këtë ligj.
3. Barazia gjinore në veprimtaritë kërkimore-shkencore synon eliminimin e paragjykimeve dhe pabarazive gjinore, përmirësimin e ekuilibrit mes punës dhe jetës dhe promovimin e barazisë midis grave dhe burrave, duke përfshirë parimin e pagës së barabartë pa diskriminim bazuar në gjini.
4. Mosdiskriminimi në veprimtaritë kërkimore-shkencore synon eliminimin e pabarazive në lidhje me moshën, aftësinë e kufizuar, racën, përkatësinë etnike, fenë, besimin dhe orientimin seksual.
5. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe inovacionit bazohet në bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitutional, duke respektuar në mënyrë të ndërsjelltë detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të çdo institucioni, si dhe parimet e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA).
6. Financimi i veprimtarive kërkimore-shkencore dhe inovative siguron barazi, eficiencë, efektivitet dhe transparencë të përdorimit të fondeve.

Neni 5

Shkenca e hapur

1. Institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor, të financuara apo të bashkëfinancuara me mjete financiare publike, zbatojnë parimin e shkencës së hapur.

2. Të dhënat dhe produktet e kërkimit shkencor, të financuara dhe bashkëfinancuara me fonde publike, duhet të jenë të hapura, të aksesueshme, të ndërveprueshme dhe të ripërdorëshme, duke i'u nënshtruar kufizimeve të vendosura nga mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, mbrojtja e të dhënave personale, si dhe siguria e individëve ose e shtetit.
3. Kërkuesit shkencorë ose çdo përfitues i financimit publik të kërkimit shkencor duhet t'i bëjë publikimet e tij të disponueshme dhe të aksesueshme për publikun.
4. Parimi i shkencës së hapur dhe praktikrat që e stimulojnë atë janë kritere të vlerësimit të institucioneve, projekteve kërkimore, dhe karrierës së kërkuesit shkencor.
5. Praktikrat dhe mekanizmat që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur miratohen me udhëzimin nga ministri në përputhje me politikat e zonës europiane të kërkimit.
6. Infrastruktura e hapur bën të mundur që kërkuesit shkencorë të ndajnë dhe të përpunojnë rezultatet e të dhënave të kërkimit, të financuara ose bashkëfinancuara me fonde publike, përtej kufijve kombëtarë dhe pavarësisht fushës së kërkimit shkencor.

Neni 6

Klasifikimi i fushave të kërkimit shkencor

1. Fushat e kërkimit shkencor janë shkencat natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjeksore, bujqësore, sociale dhe humane.
2. Klasifikimi i fushave dhe nënfushave të kërkimit shkencor miratohet me udhëzim nga ministri përgjegjës për shkencën, bazuar në sistemin europian të kërkimit shkencor.

KREU II

ORGANIZIMI I SISTEMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR

Neni 7

Ministria përgjegjëse dhe roli i saj

1. Ministria është institucioni përgjegjës që harton, drejton dhe realizon politikat e programit qeverisës në fushën e kërkimit shkencor.
2. Ministria ka këto kompetenca:
 - a) harton politika në fushën e kërkimit shkencor si dhe i propozon Këshillit të Ministrave, miratimin e planit strategjik në këtë fushë;
 - b) harton dhe propozon bazën ligjore në fushën e kërkimit shkencor;
 - c) harton dhe propozon në Këshillin e Ministrave fushat prioritare të kërkimit shkencor;
 - d) propozon në Këshillin e Ministrave modelin e financimit të buxhetit për kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi;
 - e) kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të kërkimit shkencor, financiar me fonde publike, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

- f) administron Regjistrin Shtetëror të Kërkuesve Shkencorë dhe Institucioneve të Kërkimit Shkencor në përputhje me këtë ligj;
- g) harton dhe propozon për miratim pranë Këshillit të Ministrave Kodin e Etikës në kërkimin shkencor, të harmonizuar me atë të Zonës Europiane të Kërkimit.

Neni 8

Këshilli Kombëtar për Shkencën

1. Këshilli Kombëtar për Shkencën (KKSh) është organ këshillimor që krijohet dhe funksionon pranë ministrit.
2. KKSh thirret dhe mblidhet me kërkesë të ministrit.
3. Anëtarët e KKSh emërohen nga ministri sipas nje procedure që mban në konsideratë parimin e barazisë gjinore. Jo më pak se gjysma e anëtarëve të këtij këshilli janë përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, si personalitete të njohura të fushave shkencore.
4. Rregulla të hollësishme për përbërjen, organizimin, funksionimin, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë, si dhe shpërblimin e anëtarëve të KKSh përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Funksionet e Këshillit Kombëtar për Shkencën

Funksionet kryesore të KKSh janë:

1. Këshillon ministrin për hartimin e politikave për kërkimin shkencor.
2. Këshillon ministrin për përcaktimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor.
3. Jep mendim ministrit për sistemin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe për hartimin e kriterëve për dhënien e lejes, për institucionet e kërkimit shkencor.
4. Jep mendim për politikat që lidhen me përmirësimin e veprimtarisë kërkimore shkencore.
5. Këshillon mbi çështje që kanë të bëjnë me sistemin kombëtar të shkencës si dhe integrimin e këtij sistemi në zonën evropiane të kërkimit (ERA).
6. Këshillon lidhur me rezultatet dhe metodologjinë e vlerësimit të kërkimit shkencor.

KREU III

PERSONELI KËRKIMOR SHKENCOR

Neni 10

Personeli i institucioneve të kërkimit shkencor

1. Personeli i institucioneve të kërkimit shkencor përbëhet nga punonjës kërkimorë shkencorë dhe punonjës ndihmës teknik dhe administrativ. Punësimi i tyre bëhet me kontratë nga

- drejtuesi i institucionit, në përputhje me legjislacionin për Kodin e Punës, me kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.
2. Punonjësit kërkimorë shkencorë rekrutohen nëpërmjet një konkurrimi publik, bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara në statutet dhe rregulloret e brendshme të institucionit.
 3. Në personelin ndihmës teknik përfshihen punonjësit që kanë kualifikimin profesional të duhur për të kontribuar në veprimtarinë shkencore nën drejtimin e personelit kërkimor shkencor, në përputhje me përshkrimin e vendit të punës.
 4. Në personelin administrativ përfshihen punonjës, të cilët ushtrojnë detyra administrative dhe mbështetëse të veprimtarisë kërkimore shkencore, në përputhje me përshkrimin e vendit të punës.
 5. Institucionet e kërkimit shkencor kanë të drejtë të punësojnë për periudha të shkurtra kohe studiu, personalitete në fushën e kërkimit shkencor, vendas ose të huaj. Personeli i ftuar punësohet dhe shpërblehet sipas përcaktimeve në statutin, rregulloret e institucionit dhe në përputhje me legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë.
 6. Niveli i pagës dhe kategorizimet në pagë, të personelit të institucioneve publike të kërkimit shkencor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrat e punonjësit kërkimor shkencor

1. Punonjësi kërkimor shkencor ka të drejtë:
 - a) të zgjedhë lirshëm drejtimin e metodën e kërkimit shkencor sipas synimeve të tij shkencore si dhe në funksion dhe përputhje me veprimtarinë e misionin e institucionit pranë të cilit është i punësuar;
 - b) të marrë pjesë në formimin e kërkuesve dhe specialistëve të lartë për fushën përkatëse nëpërmjet aktivitetit të mësimdhënies në të gjitha ciklet e studimit, si dhe udhëheqjes së diplomës të ciklit të dytë dhe tretë në përputhje me kriteret e akteve nënligjore përkatëse;
 - c) të ketë mbështetjen e nevojshme financiare për realizimin e planit të punës kërkimore shkencore dhe promovimin e tij në karrierë;
 - d) të ketë kushtet e duhura logjistike dhe të punës, në kryerjen e veprimtarisë së tij kërkimore shkencore;
 - e) të marrë pjesë në kurse kualifikimi, shkëmbim përvoja, ose veprimtari kërkimore shkencore pranë institucioneve homologe dhe të tjera të ngjashme, brenda ose jashtë vendit;
 - f) të vlerësohet dhe shpërblehet për punën e tij në bazë të cilësisë dhe rëndësisë së rezultateve, si dhe për punën shtesë në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari të kërkimit shkencor. Masa dhe mënyra e shpërblimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.
 - g) të botojë punimet dhe rezultatet e tij në revistat dhe periodikët shkencor sipas zgjedhjes së tij;
 - h) të gëzojë të drejtat e tij intelektuale të rezultateve dhe botimeve të tij, sipas legjislacionit përkatës e parashikimeve kontraktore me institucionin ku është punësuar.

2. Punonjësi kërkimor shkencor ka detyrimin të:
 - a) zbatojë statutin dhe rregulloren e institucionit kërkimor shkencor;
 - b) respektojë kodin e etikës;
 - c) zbatojë programin e veprimtarisë kërkimore shkencore;
 - d) respektojë parimet e shkencës së hapur;
 - e) ndjekë programet e detyrueshme të kualifikimit të përcaktuara me aktet e brendshme të institucionit të kërkimit shkencor.
3. Të drejtat dhe detyrimet të tjera të personelit, përcaktohen në statutet dhe aktet përkatëse të institucionit në përputhje me këtë ligj.

Neni 12

Kategoritë e punonjësve kërkimor shkencor dhe kriteret për fitimin e kategorive

1. Punonjësit kërkimorë shkencorë klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:
 - a) Asistent kërkues shkencor;
 - b) kërkues shkencor;
 - c) kërkues shkencor i avancuar;
 - d) drejtues kërkimor shkencor.
2. Fitimi i secilës prej kategorive, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:
 - a) Kategorinë “Asistent kërkues shkencor”, e fiton çdo punonjës i institucioneve të kërkimit shkencor në momentin e emërimit me kohë të plotë. Punonjësit e kësaj kategorie duhet të kenë fituar së paku diplomën “Master i shkencave”.
 - b) Kategorinë “Kërkues shkencor” e fiton:
 - i) çdo punonjës kërkimor shkencor i kategorisë asistent kërkues shkencor, i cili ka fituar gradën shkencore “Doktor” ose ka kryer veprimtari kërkimore shkencore për së paku 3 (tre) vjet dhe që ka arritur rezultate nga këto veprimtari, të matshme sipas treguesve të përcaktuar në statutin e institucionit kërkimor shkencor;
 - ii) menjëherë pas emërimit në këtë kategori, çdo person, i cili ka fituar gradën shkencore “Doktor” ose çdo person i cili ka kryer veprimtari kërkimore shkencore për së paku 5 (pesë) vite në një institucion tjetër të kërkimit shkencor dhe që ka arritur rezultate nga këto veprimtari, të matshme sipas treguesve të përcaktuar në statutin e institucionit kërkimor shkencor.
 - c) Kategorinë “Kërkues shkencor i avancuar” e fiton çdo punonjës kërkimor shkencor që ka fituar kategorinë “Kërkuesi shkencor” dhe që kryen veprimtari kërkimore shkencore për së paku 5 (pesë) vite në këtë kategori, me rezultate të matshme sipas kriterëve të përcaktuara në statutin e institucionit. Në rastin kur personi mban titullin “Profesor i asociuar” ose ka fituar gradën “Doktor” në një nga vendet e BE-së, kjo kategori i jepet drejtpërsëdrejti pas emërimit.
 - d) Kategorinë “Drejtues kërkimor shkencor” e fiton çdo punonjës kërkimor shkencor që ka fituar kategorinë “Kërkues shkencor i avancuar” dhe që kryen veprimtari kërkimore

shkencore brenda ose jashtë vendit për së paku 5 (pesë) vite pas fitimit të kategorisë së fundit, me rezultate të matshme sipas kritereve të përcaktuara në statutin e institucionit. Në rastin kur personi mban titullin akademik “Profesor”, kjo kategori i jepet drejtpërsëdrejti pas emërimit.

Neni 13

Titulli Shkencëtar Emeritus

1. Institucionet e kërkimit shkencor i akordojnë titullin “Shkencëtar Emeritus” punonjësve të kategorisë “Drejtues kërkimor shkencor” pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur kërkimore shkencore, pas marrjes së mendimit të argumentuar me shkrim nga Këshilli Kombëtar i Shkencës.
2. Shkencëtari Emeritus, sipas nevojave të institucionit kërkimor shkencor, mund të marrë pjesë në projekte shkencore dhe veprimtari të tjera.
3. Procedura e akordimit të titullit “Shkencëtar Emeritus” dhe të drejtat që lidhen me të përcaktohen në statutin e institucionit kërkimor shkencor.

Neni 14

Lëvizshmëria e punonjësit kërkimor shkencor

1. Punonjësit kërkimorë shkencorë, në kuadër të një projekti apo marrëveshje bashkëpunimi, mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre kërkimore shkencore pranë një institucioni kërkimor shkencor jashtë vendit, për një periudhe kohore të caktuar. Rregullat, kriteret e kohëzgjatja e periudhës së qëndrimit dhe marrëdhëniet administrative dhe raportet e punonjësit me institucionin kërkimor përcaktohen me marrëveshje midis palëve, bazuar në aktet e brendshme të institucionit ku është punësuar.
2. Punonjësit kërkimorë shkencorë të huaj mund ushtrojnë veprimtarinë e tyre kërkimore shkencore pranë një institucioni kërkimor shkencor në kuadër të një projekti apo marrëveshje bashkëpunimi, për një periudhe të caktuar kohe, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe aktet e brendshme të institucionit.

Neni 15

Periudhe sabbatike

1. Punonjësi kërkimor-shkencor ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit për përparimin e tij profesional, një herë në 7 (shtatë) vjet, për periudha kohe deri në 1 (një) vit.
2. Miratimi i periudhës sabbatike bëhet nga titullari i institucionit, pas marrjes së mendimit paraprak nga njësia ku zhvillon veprimtarinë kërkimore shkencore. Të drejtat dhe detyrimet

e përfituesit të periudhës sabbatike përcaktohen në statutin e institucionit dhe rregulloret e brendshme.

Neni 16

Vlerësimi i punës së punonjësit kërkimor shkencor

1. Rezultatet e punës së punonjësit kërkimor shkencor vlerësohen në vazhdimësi në mënyrë periodike në institucionin ku ushtron aktivitetin, prej strukturave të ngritura për këtë qëllim.
2. Kriteret e përgjithshme për vlerësimin e aktivitetit kërkimor shkencor përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU IV

INTEGRITETI NË KËRKIMIN SHKENCOR

Neni 17

Kodi i Etikës në kërkimin shkencor

1. Kodi i Etikës në kërkimin shkencor është dokument kryesor për garantimin e vlerave të kërkimit shkencor, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për shkencën, në përputhje me parimet e Zonës Europiane të Kërkimit (ERA).
2. Kodi i Etikës në kërkimin shkencor, duhet të përmbajë, të paktën:
 - a) Parimet themelore të etikës në kërkim, të cilët janë: integriteti, besueshmëria, pavarësia, paanësia dhe profesionalizmi.
 - b) Praktikrat e mira të kërkimit.
 - c) Llojet e shkeljeve dhe masave disiplinore si dhe procedurat për dhënien e tyre, në rastin e shkeljeve të etikës në kërkim.
3. Cdo institucion i kërkimit shkencor harton kodin e tij të etikës, në përputhje me këtë kod.

Neni 18

Shkeljet dhe masat disiplinore në kërkimin shkencor

1. Plagjiatura, falsifikimi dhe fabrikimi i rezultateve të kërkimit përbëjnë shkelje të rënda të etikës në kërkim.
2. Masat disiplinore dhe ato korigjuese ndaj punonjësve që shkelin etikën në kërkim, propozohen nga Komisioni i Etikës dhe jepen nga titullari i institucionit, bazuar në kodin e etikës në kërkimin shkencor. Komisioni i Etikës ngrihet pranë institucioneve të kërkimit shkencor dhe vepron në bazë të rregullores përkatëse.
3. Masa disiplinore më e rëndë është revokimi i kategorisë së punonjësit të kërkimit shkencor, e cila jepet vetëm për shkelje të rënda të etikës së kërkimit, sipas parashikimeve të këtij neni.

Punonjësi kërkimor, të cilit i është revokuar kategoria, mund të aplikojë për të njëjtën kategori me kalimin e 3 viteve nga akti i revokimit.

4. Llojet e tjera të shkeljeve dhe masat disiplinore për secilën përcaktohen në Kodin e Etikës, sipas përcaktimeve të nenit 17, të këtij ligji.

KREU V

ORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Neni 19

Institucionet e kërkimit shkencor dhe organizimi i tyre

1. Institucionet e kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë janë persona fizikë ose juridikë, publikë ose private, shqiptarë ose të huaj apo njësi përbërëse të tyre, të cilët kryejnë veprimtari të kërkimit shkencor.
2. Institucionet e kërkimit shkencor organizohen si institute kërkimore, institute të larta kërkimore, qendra kërkimore, laboratorë kërkimorë, qendra eksperimentale ose forma të tjera që zhvillojnë veprimtarinë kërkimore shkencore në përputhje me këtë ligj.
3. Institucionet e kërkimit shkencor, që organizohen dhe funksionojnë sipas akteve normative të posaçme janë:
 - a) Akademia e Shkencave në Republikën e Shqipërisë;
 - b) Institucionet e arsimit të lartë;
 - c) Parqet teknologjike dhe shkencore;
 - d) Qendrat e transferimit të teknologjive;
 - e) Institucionet kërkimore pranë ministrive, institucioneve të tjera shtetërore, apo enteve publike.
4. Me marrëveshje të posaçme mund të krijohen institucione të përbashkëta kombëtare apo ndërkombëtare të kërkimit shkencor.
5. Për interesa të përbashkëta kërkimore, studimore dhe zhvillimore institucionet e kërkimit shkencor mund të krijojnë bashkëpunime në kuadër të marrëveshjeve të përbashkëta në përputhje me aktet rregullatore të tyre.
6. Struktura e institucionit të kërkimit shkencor, përbërja, funksionimi dhe drejtimi përcaktohen në statutin dhe aktet e tjera rregullative në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

Neni 20

Instituti kërkimor shkencor

1. Instituti kërkimor shkencor zhvillon aktivitetin kërkimor shkencor si pjesë e institucionit pranë të cilit është ngritur ose në mënyrë të pavarur. Instituti duhet të ketë minimalisht 15 punonjës kërkimor shkencor, nga të cilët jo më pak se 3 duhet të jenë kërkues shkencor të avancuar.
2. Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i institutit përcaktohen në statutin dhe aktin e krijimit të tij.

Neni 21

Organet drejtuese të instituteve kërkimore shkencore dhe funksionet e tyre

1. Organet drejtuese të institutit janë këshilli shkencor dhe drejtuesi i institutit.
2. Këshilli shkencor i institutit është organi më i lartë vendimmarrës për drejtimin dhe vlerësimin e veprimtarisë shkencore të Institutit. Këshilli shkencor përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë, me një mandat 4 vjeçar.
3. Këshilli shkencor i institutit ka këto kompetenca:
 - a) përcakton politikat dhe planin strategjik, të lidhura me fushat e kërkimit shkencor në përputhje me misionin e institucionit që përfaqëson;
 - b) miraton rregulloren e institucionit;
 - c) miraton planin vjetor dhe afatmesëm të veprimtarisë kërkimore-shkencore;
 - d) shqyrton dhe miraton marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në përputhje me fushën e tij të veprimtarisë;
 - e) miraton kodin e etikës të institutit;
 - f) nxit dhe mbështet zhvillimin e karrierës profesionale të punonjësve kërkimor shkencor;
4. Përbërja, organizimi, mënyra e përzgjedhjes dhe kompetencat e tjera të këshillit shkencor përcaktohen në statutin dhe në aktin e krijimit të institutit.
5. Drejtuesi i institutit zgjidhet ose emërohet sipas përcaktimeve në statutin përkatës apo aktin e krijimit. Drejtuesi i institutit duhet t'i përkasë të paktën kategorisë “Kërkues shkencor i avancuar”, me një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje ose riemërimi vetëm 1 herë. Drejtuesi i institutit është përfaqësuesi ligjor i tij dhe drejton këshillin shkencor. Funksionet dhe kompetencat e tij përcaktohen në statutin dhe në aktin e krijimit të institutit.

Neni 22

Instituti i lartë kërkimor

1. Institutet e larta kërkimore kanë në përbërjen e tyre dy ose më shumë institute kërkimore shkencore sipas përcaktimeve në statut dhe aktin e krijimit të institutit të lartë kërkimor.
2. Përbërja e secilit institut, të institutit të lartë kërkimor duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji.

3. Organet drejtuese të institutit të lartë kërkimor janë këshilli shkencor i lartë dhe drejtuesi i institutit të lartë kërkimor.
4. Këshilli shkencor i lartë përbëhet nga jo më pak se 10 anëtarë, me një mandat 4 vjeçar që përfaqësojnë institutet përbërëse të institutit të lartë kërkimor.
5. Përbërja, organizimi, mënyra e përzgjedhjes dhe kompetencat e këshillit shkencor të lartë përcaktohen në statutin ose në aktin e krijimit të institutit.
6. Drejtuesi i institutit të lartë kërkimor zgjidhet ose emërohet sipas përcaktimeve në statutin përkatës ose aktin e krijimit. Drejtuesi i institutit të lartë kërkimor duhet t'i përkasë kategorisë "Drejtues kërkimor shkencor", me një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje ose riemërimi vetëm 1 herë. Drejtuesi i institutit të lartë kërkimor është përfaqësuesi ~~ligjor~~-i tij në raport me palët e treta dhe drejton këshillin e lartë shkencor. Funkcionet dhe kompetencat e tij përcaktohen në statutin ose në aktin e krijimit të institutit të lartë kërkimor.

Neni 23

Institucionet e tjera të kërkimit shkencor

1. Qendrat kërkimore, laboratorët kërkimorë dhe qendrat eksperimentale, e zhvillojnë aktivitetin kërkimor shkencor në mënyrë të pavarur, ose si pjesë e institucionit pranë të cilit janë ngritur.
2. Këto institucione duhet të kenë të paktën 5 (pesë) anëtarë, ku të paktën 1 (një) i përket kategorisë "Kërkues shkencor".
3. Drejtuesi i këtyre institucioneve zgjidhet ose emërohet në përputhje me statutin ose aktin e krijimit dhe duhet t'i përkasë të paktën kategorisë "Kërkues shkencor".

Neni 24

Bashkëpunimi i institucioneve të kërkimit shkencor

1. Institucionet e kërkimit shkencor bashkëpunojnë me njëra tjetrën si dhe me institucione të tjera, publike ose private, vendase ose të huaja, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit, me qëllim realizimin e misionit të tyre në fushën e kërkimit shkencor.
2. Me institucionet e arsimit të lartë bashkëpunimi bëhet kryesisht me qëllim:
 - a) zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë nëpërmjet vënies në dispozicion të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore;
 - b) zhvillimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor;
 - c) shkëmbimin e dijeve, inovacionit dhe produkteve të kërkimit.

KREU VI

KRIJIMI, RREGJISTRIMI, LICENCIMI DHE VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Neni 25

Krijimi i institucioneve të kërkimit shkencor

3. Institucionet e kërkimit shkencor krijohen me hyrjen në fuqi të aktit të krijimit ose në momentin e regjistrimit në organin përkatës, nëse kërkohet regjistrim për formën e tyre sipas legjislacionit në fuqi.
4. Në aktin e krijimit të institucionit të kërkimit shkencor përcaktohen, të paktën:
 - a) lloji i institucionit;
 - b) emri dhe selia;
 - c) misioni, objekti dhe fusha e veprimtarisë;
 - d) struktura organizative duke respektuar kriteret e këtij ligji.
5. Bashkimi ose ndarja e institucioneve kërkimore shkencore kryhet në përputhje me parashikimet e statuteve përkatëse me akt të posaçëm, i cili përmban të paktën elementët e përcaktuar më sipër.
6. Riorganizimi i brendshëm i institucioneve të kërkimit shkencor bëhet me propozim të një ose disa njësisve përbërëse dhe miratim të organeve drejtuese, në përputhje me statutin përkatës.
7. Institucionet e kërkimit shkencor fillojnë ushtrimin e veprimtarisë së tyre që nga data e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Institucioneve dhe Kërkuesve Shkencorë.

Neni 26

Statuti dhe aktet e brendshme të institucioneve

Institucionet e kërkimit shkencor rregullojnë veprimtarinë e tyre në bazë të këtyre akteve:

1. Statuti i një institucioni kërkimor shkencor përmban normat bazë, që rregullojnë veprimtarinë e tij dhe miratohet nga organi drejtues i institucionit të kërkimit shkencor. Në statut, në përputhje me këtë ligj dhe me aktin e krijimit të institucionit të kërkimit shkencor, përcaktohen: organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.
2. Rregulloret e institucioneve të kërkimit shkencor rregullojnë veprimtarinë e tyre të brendshme. Ato hartohen dhe miratohen në përputhje me këtë ligj dhe sipas mënyrës së përcaktuar në statutin e institucionit të kërkimit shkencor.
3. Kodi i etikës së institucionit kërkimor miratohet në përputhje me parimet e përgjithshme të etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor.
4. Dokumenti strategjik përcakton vizionin, misionin, objektivat dhe planin e masave për arritjen e tyre. Ky dokument duhet të hartohet në përputhje me strategjinë kombëtare të kërkimit shkencor.

5. Plani për barazinë gjinore, i cili nxit pjesëmarrje të barabartë gjinore në organizimin e organeve drejtuese dhe veprimtaritë kërkimore.

Neni 27

Regjistri Kombëtar i Institucioneve dhe Kërkuesve Shkencorë

1. Regjistri Kombëtar i institucioneve të kërkimit shkencor dhe kërkuesve shkencorë është regjistër unik ku regjistrohen dhe ruhen të dhëna për institucionet e kërkimit shkencor dhe kërkuesit shkencorë. Ky regjistër mbahet dhe administrohet nga ministria përgjegjëse për shkencën.
2. Në këtë regjistër pasqyrohen të dhënat e aktit të krijimit të institucionit të kërkimit shkencor si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin përkatës të ministrit.
3. Forma, përmbajtja, elementët e regjistrit dhe procedurat e krijimit, administrimit të informacionit, si dhe dokumentacioni që duhet të depozitohen për regjistrim, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 28

Leje për ushtrimin e një veprimtarie të një fushe të rëndësie të veçantë

1. Institucionet e kërkimit shkencor që krijohen për të ushtruar veprimtarinë e tyre në fusha të një rëndësie të veçantë, para regjistrimit në regjistrin kombëtar të kërkimit shkencor, duhet të pajisen me lejen përkatëse.
2. Me këtë leje duhet të pajisen edhe institucionet e kërkimit shkencor, të cilat e shtojnë në aktivitetin e tyre veprimtarinë në fushat e një rëndësie të veçantë.
3. Fushat e rëndësishme të veçantë të kërkimit shkencor, për të cilët kërkohet leje e veprimtarisë kërkimore shkencore, kriteret dhe procedurat për lëshimin e lejes, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29

Mbyllja e institucionit të kërkimit shkencor

1. Institucionet e kërkimit shkencor mbylLEN:
 - a) me iniciativën e tyre;
 - b) në rastet e mbarimit të personalitetit juridik të institucionit të kërkimit shkencor, sipas parashikimeve ligjore;
 - c) për shkak të shkeljeve ligjore në kryerjen e veprimtarisë së tyre;
 - d) për shkak të mospërmbushjes së misionit për një periudhë të caktuar kohe.
 - e) për shkak të vlerësimit negativ të përsëritur.

2. Për rastet e pikave (c), (ç) dhe (d) të pikës 1, mbyllja bëhet me akt të ministrit përgjegjës për shkencën. Rregullat dhe procedurat për mbylljen në këto raste përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shkencën.
3. Institucioni i kërkimit shkencor mbyllet me akt të posacëm, i cili përmban dhe elementët e mëposhtëm:
 - a) aktet kalimtare që nevojiten për administrimin e aseteve të institucionit, pronësisë intelektuale, dokumentacionit në proces, si dhe vijueshmërinë e marrëdhënieve të punësimit të stafit përkatës;
 - b) likuidimin e të drejtave dhe detyrimeve.
4. Procedura të detajuara për mbylljen e institucionit të kërkimit shkencor parashikohen në statutin e tij.
5. Akti për mbylljen e institucionit të kërkimit shkencor depozitohet pranë Regjistrat Kombëtar të Institucioneve dhe Kërkuesve Shkencorë.

Neni 30

Vlerësimi i institucioneve të kërkimit shkencor

1. Institucionet e kërkimit shkencor, të cilat financohen nga fonde publike, i nënshtrohen periodikisht vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ministria përgjegjëse për shkencën. Në përfundim të vlerësimit, ministri përgjegjës për shkencën merr masat përkatëse.
2. Procedurat, kriteret, metodologjia e këtij vlerësimi si dhe llojet e masave, miratohen me vendim të këshillit të ministrave.

Neni 31

Statusi i “qendrës së ekselencës”

1. Institucioni i kërkimit shkencor apo njësitë përbërëse të tij, që arrijnë rezultate të spikatura në nivel kombëtar ose ndërkombëtar në fushën e kërkimit, mund të fitojnë statusin “Qendër Ekselence”.
2. Statusi i “Qendrës së Ekselencës” jepet nga ministri përgjegjës për shkencën në një afat kohor të caktuar, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin përkatës të ministrit.
3. Institucionet apo njësitë përbërëse me statusin “Qendër Ekselence” mund të përfitojnë fonde shtesë nga buxheti i shtetit, të dedikuara për kërkimin shkencor.

KREU VII

FINANCIMI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Neni 32

Burimet e financimit

1. Institucionet e kërkimit shkencor financohen me fonde nga:
 - a) buxheti i shtetit;
 - b) projektet ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit;
 - c) kryerja e veprimtarive të kërkimit shkencor dhe inovacionit;
 - d) shërbime tekniko-shkencore për të tretët;
 - e) të drejtat e pronësisë intelektuale si patentat, shpikjet, veprat e ndryshme, etj;
 - f) aplikimi në praktikë i rezultateve të veprimtarisë kërkimore dhe inovacionit nga institucionet e kërkimit shkencor;
 - g) dhurime nga donatorë të ndryshëm;
 - h) burime ose veprimtari të tjera të ligjshme.
2. Institucionet e kërkimit shkencor janë të detyruara të sigurojnë një përdorim sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.
3. Burimet financiare të vëna në dispozicion të institucioneve të kërkimit shkencor, nga organizma privatë ose ndërkombëtarë, përdoren vetëm për përmbushjen e misionit dhe objektivave të këtyre institucioneve.
4. Për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera publike, të cilët aktualisht ushtrojnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor dhe organizohen me ligj të veçantë, burimet e financimit rregullohen sipas ligjit përkatës.

Neni 33

Mënyrat e financimit për institucionet publike të kërkimit shkencor

1. Financimi nga buxheti i shtetit për institucionet publike të kërkimit shkencor do të jetë në formë granti si transfertë e kushtëzuar për veprimtarinë e tyre.
2. Fondet e buxhetit të shtetit për veprimtarinë e kërkimit shkencor janë zë i veçantë brenda planit buxhetor të ministrisë përgjegjëse për shkencën, të kushtëzuara për realizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.
3. Mënyra e financimit nga buxheti i shtetit dhe kategorizimi i fondeve buxhetore për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera publike, të cilët aktualisht ushtrojnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor dhe organizohen me ligj të veçantë, rregullohen sipas ligjit të veçantë.
4. Burimet financiare për veprimtarinë e kërkimit shkencor për institucionet publike planifikohen, miratohen, administrohen, pasqyrohen dhe raportohen sipas legjislacionit në fuqi, për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
5. Financimi për veprimtarinë e kërkimit shkencor nga buxheti i shtetit, kryhet si “financim

- institucional” (administrativ), për organizimin administrativ të njësisë publike të kërkimit shkencor dhe si “financim i programeve apo projekteve të kërkimit shkencor”.
6. Financimi i programeve apo projekteve kërkimore bëhet mbi baza konkurruese.
 7. Modeli i financimit për institucionet publike të kërkimit shkencor, miratohet nga Këshilli i Ministrave, pas propozimit nga ministri përgjegjës për shkencën.

Neni 34

Financimi shtetëror për institucionet private të kërkimit shkencor

1. Institucionet private të kërkimit shkencor, mund të financohen me fonde grant nga buxheti i shtetit për programe apo projekte të fituara me konkurim. Kriteret për konkurim përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shkencën.
2. Për përdorimin e fondeve publike, institucionet e kërkimit shkencor i nënshtrohen auditimit financiar.

Neni 35

Bashkëfinancimi i projekteve kërkimore

1. Institucionet e kërkimit shkencor për projekte kërkimore të veçanta mund të financohen nga fonde të krijuara nga bashkimi i dy ose më shumë burimeve të mëposhtme:
 - a) buxheti i shtetit;
 - b) financime nga subjekte private;
 - c) financime nga institucione ndërkombëtare.
2. Masa e financimeve rregullohet në marrëveshjen përkatëse dy ose më shumë palëshe që lidhin institucionet e kërkimit shkencor.

Neni 36

Lehtësime fiskale të financimit të kërkimit shkencor

Personat fizikë dhe juridikë private kur financojnë veprimtaritë e kërkimit shkencor lehtësohen në masat dhe mënyrat e përcaktuara me ligj.

Neni 37

Menaxhimi i Aseteve në institucionet e kërkimit shkencor

1. Institucionet kanë në administrim ose në pronësi godinat ku zhvillojnë aktivitetin, pajisjet, revistën, bibliotekën, muzeun, produkte të krijimtarisë intelektuale. Institucionet e kërkimit shkencor, gjatë aktivitetit të tyre krijojnë apo zhvillojnë asete financiare apo fizike nëpërmjet burimeve të ligjshme të financimit.

2. Pronat e paluajtshme, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre institucionet publike të kërkimit shkencor, që shërbejnë për të garantuar përmbushjen e misionit të institucionit, kalojnë në administrim të tij, me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për shkencën.
3. Institucionet publike të kërkimit shkencor, kanë detyrimin të ruajnë dhe të mirëmbajnë pronat në administrim dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre. Institucionet mund të zhvillojnë pronat me miratim paraprak të subjektit që i ka kaluar pronën në administrim.

KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 38 Dispozita kalimtare

1. Të gjithë institucionet kërkimore shkencore të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë detyrimin të depozitojnë informacionin dhe dokumentacionin në përputhje me elementët e Regjistrit Kombëtar të Institucioneve dhe Kërkuesve Shkencorë, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Vlerësimi i parë i institucioneve kërkimore shkencore ekzistuese bëhet brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në nenin 39 të këtij ligji.

Neni 39 Aktet nënligjore

Aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, pika 2, nenit 8, pika 4, nenit 10, pika 6, nenit 11, pikës 1, shkronja “f”, nenit 16, pika 2, nenit 17, pika 1, nenit 27, pika 3, nenit 28, pika 3, nenit 29, pika 3, nenit 30, pika 2, nenit 31, pika 2 dhe nenit 33, pika 7, miratohen brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 40 Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 7893 datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 41
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.